STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 25 prill 2013

ADMINISTRATA KUOMO (CUOMO) KERKON QE ZYRAT E KREDISE TE NDERMARRIN VEPRIM TE MENJEHERSHEM PER TE SIGURUAR SE VIKTIMAT E SENDIT (SANDY) NUK PESOJNE NJOLLA TE ZEZA TE PADREJTA NE REZULTATET E KREDISE SE TYRE

Vështirësitë financiare të lidhura me stuhinë nuk duhet të lejohen të dëmtojnë rezultatet e kredisë të viktimave të Sendit (Sandy)

Për viktimat e Sendit (Sandy), njollat në rezultatet e kredisë mund të nënkuptojnë kosto më të larta për hua të shtëpive, automjeteve e biznesit dhe vështirësi më të madhe për gjetjen e punësimit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Administrata e tij u ka kërkuar zyrave të vlerësimit dhe njoftimit të kredisë që të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të ndalur uljen e rezultateve të kredisë për viktimat e super stuhisë Sendi (Sandy) që mund të jenë duke përjetuar vështirësi të lidhura me stuhinë përtej kontrollit të tyre. Nëse agjencitë e njoftimit të kredisë nuk veprojnë, mijëra viktima të Sendit (Sandy) mund të përballen me kosto më të larta për huatë e shtëpive, automjeteve dhe biznesit.

Me udhëzim të Guvernatorit Kuomo (Cuomo), Kryeinspektori i Shërbimeve Financiare (Superintendent of Financial Services) Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky) sot u dërgoi letra FICO, TransUnion, Experian, Equifax dhe Shoqatës së Industrisë së të Dhënave të Konsumatorëve (Consumer Data Industry Association (CDIA) duke kërkuar që të veprojnë shpejt për të mbrojtur viktimat e Sendit (Sandy) dhe që zyrtarë të lartë të atyre organizatave të takohen me Departamentin e Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) (DFS) të Shtetit të Nju Jorkut (New York State) sa më shpejt që të jetë e mundur për të zgjidhur këtë çështje.

“Dhënia e një njolle të zezë të padrejtë në rezultatet e kredive të tyre për viktimat e Sendit (Sandy) do të shtonte fyrje tek dëmtimi për mijëra banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) që po luftojnë të rindërtojnë dhe të rimëkëmben pas kësaj stuhie shkatërruese,” tha Guvernatori (Kuomo). “Agjencitë e njoftimit të kredisë duhet të ndërmarrin veprim të shpejtë në mënyrë që viktimave të Sendit (Sandy) të mos u prishen padrejtësisht rezultatet e kredive të tyre.”

Kryeinspektori (Superintendent) Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky) tha, “Asnjë viktimë e Sendit (Sandy) nuk duhet të përballet me një goditje të historisë së kredisë së tyre thjesht sepse e pësuan nga Nëna Natyrë dhe u ndodhën në rrugën e kësaj stuhie shkatërruese. Kjo çështje është mjaft e rëndësishme për Guvernatorin Kuomo (Cuomo) sepse rezultati i kredisë së një personi mund të ndikojë në gjithshka, nga niveli që paguajnë për një hipotekë tek shanset e tyre për të gjetur një punë të re.”

Sfidat financiare me të cilat përballen shumë banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) për shkak të super stuhisë Sendi (Sandy) mund të ndikojnë negativisht në rezultatet e kredisë së tyre për arsye që nuk kanë lidhje me vlerën e kredisë. Për shembull, shumë pronarë të shtëpive nuk bënë disa pagesa të hipotekës për shkak të Sendit (Sandy) ose u detyruan të kërkonin moskryerjen e pagesave të hipotekave të tyre përballë shpenzimeve në rritje të lidhura me rimëkëmbjen. Shumë qytetarë të tjerë nuk ishin në gjendje të bënin pagesa në kohë të qirave kur shtëpitë e tyre u bënë të pabanueshme dhe ata u detyruan të paguanin për strehim alternativ. Pronarët e shtëpive dhe pronarët e bizneseve gjithashtu e gjetën veten duke marë hua për pajisje thelbësore për të rindërtuar shtëpitë dhe bizneset e tyre.

Administrata ka kërkuar që zyrat e kredisë të ndërmarrin katër veprimet e mëposhtme:

1. Të ndërmarrin veprim të menjëhershëm për të siguruar se rezultatet e kredisë nuk ulen për viktimat e Sendit (Sandy);
2. Të rivendosin ndonjë rezultat që ishte ulur tashmë;
3. Të punojnë me banka dhe huadhënës të tjerë për të rregjistruar ndonjë informacion negativ që vjen nga viktimat e katastrofës;
4. Dhe të takohen me Departamentin e Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) për të ndryshuar në mënyrë të përherëshme procedurat për të parandaluar që rezultatet e kredisë të ulen për viktimat e katastrofës.

Një njollë e zezë e padrejtë në historinë e kredisë të një personi mund të ketë pasoja të rënda financiare për një kohë të gjatë. Mund të nënkuptojë kosto më të larta për një hipotekë, një hua për makinë ose një hua të një biznesi të vogël për shumë vjet në të ardhmen – duke tërhequr nga buxhetet e viktimave të Sendit (Sandy) që janë tashmë duke u përpjekur të rindërtojnë dhe të rimëkëmben. Edhe më keq, disa viktima të Sendit (Sandy) mund të përjashtohen nga tregu i punës pasi shumë punëdhënës kontrollojnë dhe mohojnë kërkuesit mbështetur në njollat në historinë e kredisë së tyre – pavarësisht nëse ajo njollë është shkaktuar nga një gabim i bankës ose ndodhi pa fajin e vetë kërkuesit.

Super stuhia Sendi (Sandy) pati një ndikim shkatërrues mbi mijëra familje në Nju Jork (New York) dhe anembanë verilindjes. Banorët u detyruan të siguronin strehim të përkohëshëm kur shtëpitë e tyre u bënë të pabanueshme; riparime të kushtueshme të shtëpisë krijuan shpenzime të papritura dhe që nuk ishin në buxhet; dhe shumë biznese mbyllën dyert përkohësisht ose përgjithëmonë, duke lënë pronarët dhe punonjësit e tyre të përballen me humbje të konsiderueshme të të ardhurave. Për të ndihmuar që banorët e Nju Jorkut (New Yorker) në vështirësi të rimëkëmben, Guvernatori Kuomo (Cuomo) dhe Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) kanë qënë duke punuar me

këto familje dhe institucionet financiare të tyre në një numër mënyrash, përfshirë përpunimin e përshpejtuar të kërkesave të sigurimit, lehtësimin e kufizimeve për dhënien nga bankat të të ardhurave nga sigurimi për pronarët e shtëpive dhe lehtësimin e ndihmës së hipotekave për pronarët e shtëpive në vështirësi. Këto masa u morrën për të ndihmuar në sigurimin se askush nuk përballet me humbjen e shtëpisë, falimentimin ose shkatërrim tjetër financiar thjesht për shkak të pasojave shkatërruese të Sendit (Sandy).

Për të lexuar një kopje të letrës së Kryeinspektorit (Superintendent) Loski (Lawsky) për agjencitë e njoftimit të kredisë, ju lutemi vizitoni http://www.governor.ny.gov/assets/documents/FICOLetter.pdf.

Viktimat e Sendit (Sandy) që mendojnë se rezultati i kredisë së tyre është prekur në mënyrë të padrejtë duhet të kontaktojnë DFS në **1-800-339-1759**.

Mbështetësi i Konsumatorit për NYPIRG Endi Morrison (Andy Morrison) tha, "Agjencitë e njoftimit të kredisë nuk ishin përgjegjëse për super stuhinë Sendi (Sandy) – ishte një vepër e Zotit. Por ato mund të ndalojnë së ndëshkuari banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) se janë me vonesë ose nuk kanë bërë pagesën e faturave dhe së rrezikuari aftësinë e tyre për të marë hipoteka, kredi ose edhe një vend pune. Mirësia njerëzore dhe drejtësia diktojnë që agjencitë e kredisë të mos ndëshkojnë banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) për atë që është përtej kontrollit të tyre. NYPIRG përgëzon Guvernatorin Kuomo (Cuomo) dhe Kryeinspektorin (Superintendent) e DFS-së Loski (Lawsky) për ndërhyrjen pranë industrisë së njoftimit të kredisë për llogari të banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers)."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418